

UDC 342.571(497.7)

Driton Kuci, PhD candidate

Pishtar LUTFIU, PhD candidate

## **PROCESI I PARTICIPIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

### **ПРОЦЕСОТ НА ПАРТИЦИПАЦИЈА ВО РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА**

### **THE PROCESS OF PARTICIPATION IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA**

---

#### **Abstract**

Process of developments proved that the communist regime could not provide full legitimacy, sustainable and guarantees of its authority.

In the Republic of Macedonia the proces of participation as an important element of one democratic society is undergoing in a legal regulation from in which begin the institutional functionality and legislative legitimacy.

In this paper will be analyzed the legal framework. A formal fundamental sources of law material is definitely constitution of a country. The Constitution represents the main pillar and is the main regulator of social relations in a society. As the highest legal act, the Constitution contains provisions which regulate and enable the realization of the rights of citizens through participation process.

Also as part of this research is the institutional framework. Citizens in any democratic or undemocratic society enjoy the right to participate in the institutions of public character and the right to be informed about the work of government institutions,

parliamentary activity, the work of the courts, local administration and functioning of all institutions of public character.

In political science the term legitimacy or recognition implies acceptance as valid laws by citizens or validity of the ruling regime. Guaranteed political legitimacy through free elections and democratic legitimacy of the regime and guaranteed when citizens accept and subject to the laws, and in return they are guaranteed their legal rights.

### Abstrakt

Zhvillimet në proces provuan se regjimi komunist nuk mundi të siguronte legjitimitetin e plotë, të qëndrueshëm dhe si garanci të autoritetit të tij.

Edhe në Republikën e Maqedonisë procesi i participimit si një element i rëndësishëm i një shoqërie demokratike i nënshtrohet një rregullimit ligjor prej ku buron funksionaliteti institucional dhe legjitimiteti ligjvënës.

Në këtë punim do të analizohen korniza juridike. Një ndër burimet themelore formale e materiale të së drejtës është padyshim Kushtetuta e një vendi. Kushtetuta paraqet shtyllën kryesore dhe është rregulluesi kryesor i marrëdhënieve shoqërore në një shoqëri. Si akti më i lartë juridik, Kushtetuta përmban dispozita me të cilat rregullon dhe mundëson realizimin e të drejtave të qytetarit nëpërmjet procesit të participimit.

Po ashtu si pjesë e këtij hulumtimi është edhe kuadri institucional. Qytetarët në çdo shoqëri demokratike apo jodemokratike gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes në institucionet e karakterit publik dhe të drejtën për t'u informuar për punën e institucioneve qeveritare, veprimtarinë parlamentare, punën e gjykatave, funksionimin e administrimit lokal dhe të gjitha institucioneve të karakterit publik.

Në shkencat politike me termin legjitimitet nënkuptohet njohje apo pranim i ligjeve si të vlefshme nga ana e qytetarëve ose vlefshmëri të regjimit qeverisës. Legjitimiteti politik garantohet nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe demokratike, kurse legjitimiteti i regjimit garantohet atëherë kur qytetarët i pranojnë dhe u nënshtrohen ligjeve, dhe si shpërblim atyre u garantohen të drejtat e tyre ligjore.

## HYRJE

Zhvillimet në proces provuan se regjimi komunist nuk mundi të siguronte legjitimitetin e plotë, të qëndrueshëm dhe si garanci të autoritetit të tij<sup>168</sup>.

Edhe në Republikën e Maqedonisë procesi i participimit si një element i rëndësishëm i një shoqërie demokratike i nënshtrohet një rregullimit ligjor prej ku buron funksionaliteti institucional dhe legjitimiteti ligjvënës.

### 2.1. Korniza juridike

Një ndër burimet themelore formale e materiale të së drejtës është padyshim Kushtetuta e një vendi. Kushtetuta paraqet shtyllën kryesore dhe është rregulluesi kryesor i marrëdhënieve shoqërore në një shoqëri. Si akti më i lartë juridik, Kushtetuta përmban dispozita me të cilat rregullon dhe mundëson realizimin e të drejtave të qytetarit nëpërmjet procesit të participimit.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, ua siguron qytetarëve të drejtën e qeverisjes nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të tyre, si dhe formave tjera të shprehjes së vullnetit të tyre. Ajo u mundëson qytetarëve që nëpërmjet pjesëmarrjes të ndikojnë në aprovimin e vendimeve me karakter publik, të rëndësishme dhe me ndikim për jetën e tyre dhe shoqërisë. Qytetarët komunikojnë drejtpërdrejtë me organet e zgjedhura dhe me administratën publike me qëllim që të ndikojnë në vendimet me karakter

<sup>168</sup> Lambro Filo: "Sistemet Politike Bashkekohore", Tirane, 2010, 383.

publik<sup>169</sup>. Se qytetari është burimi i sovranitetit në Republikën e Maqedonisë dhe se ai këtë e realizon (demonstron) nëpërmjet organizmit politik të garantuar me ligji shihet edhe në neni 2 dhe nenin 20.

### **Neni 2**

Në Republikën e Maqedonisë sovraniteti buron nga qytetarët dhe u takon qytetarëve. Qytetarët e Republikës së Maqedonisë push-tetin e realizojnë nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet referendumit dhe formave të tjera të deklaramit të drejtpërdrejtë.

### **Neni 20**

Qytetarëve u garantohet liria e bashkimit me qëllim të realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe bindjeve të tyre politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të drejtave dhe bindjeve të tjera. Qytetarët mundën lirisht të themelojnë shoqata civile dhe parti politike, të aderojnë dhe të dalin nga ato. Programet dhe veprimtaria e shoqatave civile dhe partive politike nuk mund të orientohen drejt rrënimit të dhunshëm të rendit kushtetues të Republikës dhe drejt nxitjes ose thirrjes së agresionit ushtarak, ose nxitjes së urrejtjes ose mosdurimit kombëtar, racor ose fetar. Ndalohen shoqatat ushtarake ose gjysmë ushtarake, të cilat nuk u takojnë forcave të armatosura të Republikës së Maqedonisë<sup>170</sup>.

Shtet kushtetues është ai i cili bazohet ne Kushtetutën e tij. Në atë mënyrë ai i definon tre pushtetet (legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor). Raportet e tyre janë të organizuara në atë mënyrë që asnjëri nga pushtetet nuk mund jetë funksional pa pjesëmarrjen dhe mbikëqyrjen e dy të tjerëve. Gjyqet nuk i bëjnë ligjet, ndonëse gjyqtari mund t'i interpretojë dhe t'i precizojë në një fare mënyre.

<sup>169</sup> Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është botuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" numër 52/91, ndërsa amendamentet në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" numër 1/92, 31/98, 91/2001, 84/2003 dhe 107/2005.

<sup>170</sup><http://www.sobranie.mk/al/default.asp?pSearch=kushtetuta&image2.x=0&image2.y=0>

Parlamenti i bënë ligjet, por nuk është ai që udhëheq apo qeveris: ai nuk duhet të marrë vendime të veçanta që i kërkon ndonjë situatë po ashtu e veçantë.

Pra, parlamenti duhet ta pengojë veprimin e qeverisë, për shembull duke refuzuar ti jap mjete financiare (me rastin e votimit të buxhetit). Kushtetuta po ashtu definon rregullat e marrjes së pushtetit dhe të qeverisjes si dhe precizon kushtet e zgjedhjeve dhe të votimit. Më në fund, nga një këndvështrim formal ajo i definon kushtet e modifikimit e të gjitha ligjeve ekzistuese, por njëherësh ajo i precizon edhe procedurën që duhet të ndiqet për modifikimin e vetë kushtetutës. Këto çështje kushtetutën e bëjnë të ndryshme dhe superiore nga të gjithë aktet tjera. Po të flasim me gjuhën juridike, mund të thuhet se e bëjnë “tërësi rregullash të drejtësisë interne të një shkalle më të lartë”.

Një shtet kushtetues i jep qytetarit një status preciz, i cili është rrjedhojë e ndërvarësisë së pushteteve, dhe këtë gjë Monteskieu<sup>171</sup> e definoi për herë të parë<sup>172</sup>. Qytetari ka një mbrojtje legale para tribunaleve, kundër vendimeve arbitrare të qeverisë dhe të administratës. Pavarësia e tribunalit ilustron faktin se qeveria po të këtë konflikt me qytetarin nuk mund të luajë rolin edhe të gjyqit edhe të partisë. Tribunali mund ta detyrojë shtetin, të cilin në këtë rast nuk duhet ngatërruar me administrimin, për të pranuar gabimet e veta eventuale dhe t'i korrigjojë ato. Përveç kësaj, pjesëmarrja e qytetarëve është e obligueshme në aktivitetet legjislative, qoftë e drejtpërdrejt, si në rastin e referendumit, qoftë indirekt përmes zgjedhjeve dhe një përfaqësimi nacional. Këto kushte i garantojnë individit mbrojtje nga arbitrariteti i pushtetit. Me fjalë të tjera kështu garantohen dhe mbrohen liritë themelore të njeriut.

<sup>171</sup> Montesquieu, ishte një komentator social francez dhe mendimtar politik i cili ka jetuar gjatë iluminizimit. Ai është bërë i famshëm me teorinë e artikulimit të ndarjes së pushteteve, për të cilat është marrë për diskutimet bashkëkohore të qeverisë dhe të zbatohet në kushtetutat e shumë vendeve në të gjithë botën. Ai ishte kryesisht është përgjegjës për popullarizimin e feudalizmit dhe kushteve të Perandorisë Bizantine.

<sup>172</sup> Patrice Canicez: “Éduquer Le Citoyen”, Paris, 1990, 30/31.

## 2.2. Kuadri institucional

Qytetarët në çdo shoqëri demokratike apo jodemokratike gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes në institucionet e karakterit publik dhe të drejtën për t'u informuar për punën e institucioneve qeveritare, veprimtarinë parlamentare, punën e gjykatave, funksionimin e administrimit lokal dhe të gjitha institucioneve të karakterit publik.

Komunikimi i institucioneve publike me grupe të ndryshme të qytetarëve, me mediat dhe pjesëmarrja e qytetarëve në krijimin e politikës, me marrjen e vendimeve dhe procesin e kontrollit, janë elemente të rëndësishme të secilës shoqëri të rregulluar në mënyrë demokratike<sup>173</sup>.

Rrjeti institucional për implementimin e politikës zgjedhore, kapaciteti i saj dhe fuqia financiare kanë ndikim të madh mbi atë se si implementohet politika zgjedhore në Maqedoni. Pasi që definicioni për politikën publike përfshin edhe ndërmarrjen e aktiviteteve për zgjidhjen e problemit, parregullsitë dhe moszbatimin e zgjidhjeve ligjore nga ana e organeve të cilët janë përgjegjës për implementimin, njëherësh edhe e përcaktojnë politikën zgjedhore në shtet si edhe aktet të cilat e rregullojnë atë. Nga ky këndvështrim kapacitetet institucionale të nevojshme për implementimin e politikës zgjedhore janë me rëndësi të veçantë për efektivitetin e saj në zgjidhjen e problemeve konkrete me të cilat ballafaqohet procesi zgjedhor të cilat kanë implikime më të mëdha në kapacitetin demokratik të shtetit dhe stabilitetin e tij politik.

Analizat të cilat vijojnë japin pasqyrën e problemeve individuale në mbrojtjen e së drejtës zgjedhore, implementimin e zgjedhjeve, menaxhimin me parregullsitë zgjedhore dhe financimin e fushatave zgjedhore. Njëra prej tyre përcakton nevojën e zgjerimit të kompetencave të Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) dhe Këshillave zgjedhore, pajisjen e tyre me kuadro profesionale, pajisje dhe procedura për udhëheqjen e procedurave penale dhe shqiptimin e sanksioneve ndëshkuese të cilat mund të shqiptohen dhe zbatohen edhe për

<sup>173</sup> Russell J. Dalton; Hans-Dieter Klingeman: "The Oxford Handbook of Political Behaviour", Wien, 2007, 13.

shkak të mbrojtjes së të drejtës të kandidatëve në fushatën zgjedhore. Në të dytën madje, vërehet mendimi specialist për ndryshimet e politikës me qëllim të pavarësisë më të madhe të komisionet, si edhe rritja e profesionalizmit tek KSHZ. Gjithsesi, analiza juridike e temave të lartpërmendura tregon edhe për nevojën e pastrimit dhe harmonizimit të zgjidhjeve ligjore të cilat i rregullojnë zgjedhjet me qëllim të krijimit të një sistemi koherent dhe efikas zgjedhor. Për fat të keq asnjë prej analizave nuk bën vlerësimin e kapaciteteve të institucioneve që t'i zbatojnë kompetencat e parashikuara me ligj, madje as edhe nuk ofrohen informata për mjetet financiare të nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të cilat jepen dhe për të cilat konsiderohet se do të kontribuojnë kah realizimi i rezultateve të dëshiruara<sup>174</sup>.

### 2.3. Legjitimiteti

Në shkencën politike me termin legjitimitet nënkuptohet njohje apo pranim i ligjeve si të vlefshme nga ana e qytetarëve ose vlefshmëri të regjimit qeverisës. Legjitimiteti politik garantohep nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe demokratike, kurse legjitimiteti i regjimit garantohep atëherë kur qytetarët i pranojnë dhe u nënshtrohen ligjeve, dhe si shpërblim atyre u garantohep të drejtat e tyre ligjore. Termi legjitimitet vjen nga fjala latine legitimare<sup>175</sup>. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e vitit 1991 e përfshin një numër të konsiderueshëm të të drejtave politike dhe qytetare, ndërsa sundimi i ligjit dhe shteti ligjor përcaktohen si parime themelore të sistemit të pushtetit. Meqenëse sovraniteti i shtetit buron nga qytetari dhe u takon qytetarëve, është e domosdoshme që të ketë funksionim efikas të shtetit ligjor<sup>176</sup>.

<sup>174</sup> Marija Risteska; Zhidas Daskalovski: "Krijimi i politikës zgjedhore në Republikën e Maqedonisë", Shkup, 2008, 14.

<sup>175</sup> Për më tepër, Iain Mcleandhe, Alistar McMillan: "Fjalori politik", Oxford, 2011 ose Ali Pajaziti: "Fjalor i sociologjisë, Logos-a, Shkup, 2009.

<sup>176</sup> Jonuz Abdullahi: "Politika dhe politikat publike", botimi i dytë, Tetovë, 2011, 144.

Politika zgjedhore në Maqedoni është e përbërë prej akteve ligjore vijuese:

Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Kodit zgjedhor (Vendimi i Gjykatës Kushtetuese U. Nr. 87/2006), Ligjit për financimin e partive politike, Ligji për partitë politike, Ligji për konfliktet administrative, Kodi penal, Ligji për gjykatat, Ligji për revizionin shtetëror, Ligji për ndalimin (pengimin) e korrupsionit, Ligji për paraqiten e vend jetesës dhe vendqëndrimit të qytetarëve, Ligji për nënshtetësinë, Ligji për komunitetet etnike dhe Ligji për lustrim, etj. Të gjitha këta akte juridike e vendosin kornizën ligjore në të cilën organizohen dhe realizohen zgjedhjet parlamentare, lokale dhe presidenciale. Ata i përcaktojnë funksionet dhe autorizimet e organeve të cilët zbatojnë zgjedhjet. Kjo kornizë juridike është e plotësuar edhe me akte ligjore ndërkombëtare të cilat Maqedonia i ka nënshkruar dhe ratifikuar. Me çka bëhet pjesë pozitive e vendit, ndërsa të cilët rregullojnë të drejta të caktuara lidhur me të drejtën zgjedhore dhe proceset demokratike të cilat janë parakusht për zbatimin e zgjedhjeve. Të tilla janë: Pakti ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike, Konventa për eliminimin e të gjitha llojeve të diskriminimeve ndaj femrës, Konventa për eliminimin e të gjitha llojeve të diskriminimit racor, Konventa për të drejtat politike të femrave, Konventa për të drejtat e personave me nevoja të posaçme, Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut, si edhe Deklarata për të drejtat e njeriut e Kombeve të Bashkuara dhe dokumente të tjera ndërkombëtare. Në vazhdim do të interpretojmë dy nene të Republikës së Maqedonisë, bëhet fjalë për nenin 51 dhe 52 ku ligjet janë të rregulluar me Kushtetutë.

### **Neni 51**

Në Republikën e Maqedonisë ligjet medoemos duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën, ndërsa të gjitha rregullat e tjera me Kushtetutën dhe me ligjin.

Secili e ka për detyrë ta respektojë Kushtetutën dhe ligjet.



**Neni 52**

Ligjet dhe rregullat e tjera shpallen para se të hyjnë në fuqi.

Ligjet dhe rregullat e tjera shpallen në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, më së voni brenda afatit prej shtatë ditësh nga dita e nxjerrjes së tyre. Ligjet hyjnë në fuqi jo më herët se ditën e tetë nga dita e shpalljes, me përjashtim, të cilin e përcakton Kuvendi, në ditën e shpalljes. Ligjet dhe rregullat e tjera nuk mund të kenë efekt prapaveprues, përveç përjashtimit, në rastet kur kjo është më e favorshme për qytetarët<sup>177</sup>.

Prandaj shteti bazohet në autoritetin e ligjit. Rrjedhoja e parë rreth këtij fakti ka të bëjë me edukimin e qytetarëve: shpirti i një republike, siç shprehej Montesquie, është shpirti i respektimit të ligjit si i tillë, parimisht dhe pavarësisht nga imponimet e ashpra, më shumë apo më pak të dhunshme, të cilat individ mund t’ia imponojë nënshtrimin. Si rrjedhoje, edukimi qytetar duhet te jete bartës i frymës së pajtueshmërisë së lirë dhe të vullnetshme të qytetarit për të respektuar ligjin dhe të sensit për barazi, i cili është ngushtësisht i lidhur me të. Është fakt i pamohueshëm se shteti shpeshherë përdor forcën dhe se frika ndaj dënimit luan rol të madh lidhur me respektimin e obligimeve të caktuara. Megjithatë deri atëherë kur shteti nuk do të ketë mënyrë për të vendosur një polic pas secilit individ (dhe një tjetër pas të parit, etj.), parimi i shtetit modern është që qytetarët të respektojnë ligjet, sepse ky respekt në vetëdijen e tyre duket legjitim. Ndaj dhe ky legjitimitet bazohet në dy mënyra. E para është ajo që do ta quajmë koncept konsumues të qytetarisë, ku qytetari është në një mënyrë konsumues, kurse shteti ofron shërbime. Individu gëzon të drejta të caktuara, ngase kryen detyra të caktuara. Respektimi i rregullave kolektive është i barasvlershëm me shërbimet që bashkësia i ofron individit, kurse ai në atë mënyrë ”blen” të drejtat e caktuara konform obligimeve që i kryen. Të drejtat dhe detyrat e qytetarëve janë të përcaktuara me ligj: në atë kuptim

<sup>177</sup><http://www.sobranie.mk/al/default.asp?pSearch=kushtetuta&image2.x=0&image2.y=0>

ato varen nga shteti dhe nga legjislativi shtetëror<sup>178</sup>. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë është bartës i pushtetit ligjvënës në Republikë. Kuvendi, ligjet i miraton në seanca parlamentare, ndërkaq shumica e nevojshme për miratimin e ligjeve është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë. Të drejtë që të propozojë miratimin e një ligji ka çdo deputet, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe së paku 10.000 zgjedhës (propozues të autorizuar).

Iniciativë për miratimin e ligjit, propozuesit të autorizuar mund t'i propozojë çdo qytetar, grup qytetarësh, institucione dhe shoqata. Procedura e miratimit të ligjeve është e rregulluar me Rregulloren e punës të Kuvendit. Në përputhje me Rregulloren Propozuesit e autorizuar propozim-ligjin ia dërgojnë Kryetarit të Kuvendit i cili menjëherë ose më së voni brenda tre ditëve të punës nga paraqitja ua shpërndan deputetëve në formë të shkruar ose elektronike, me çka fillon procedura ligjvënëse.

Në përputhje me Rregulloren, procedura ligjvënëse zhvillohet me tre lexime.

**Leximi i parë** do të zhvillohet nëse së paku 15 deputetë paraqesin kërkesë që Kuvendi të mbajë diskutim të përgjithshëm për propozim-ligjin. Kërkesa paraqitet brenda afatit prej shtatë ditësh. Nëse parashtrrohet kërkesë për mbajtjen e diskutimit të përgjithshëm për ndonjë propozim ligj para se të shqyrtohet propozimi në seancë të Kuvendit, propozimin e shqyrtojnë trupi punues amë dhe Komisioni Juridiko-Ligjvënës. Komisionet vlerësojnë për atë nëse Propozimi është i pranueshëm dhe se a duhet të kalojë në lexim të mëtutjeshëm. Në leximin e parë, pas diskutimit të zhvilluar të përgjithshëm Kuvendi vendos për atë se a është i pranueshëm Propozim-ligji dhe a mund të kalojë në lexim të mëtutjeshëm. Pas vendimit të Kuvendit se propozim-ligji është i pranueshëm dhe se mund të kalojë në lexim të mëtutjeshëm, procedura ligjvënëse vazhdon me Leximin e dytë të propozimit. Propozim-ligji shqyrtohet në Leximin e dytë edhe nëse brenda afatit të përcaktuar së paku 15 deputetë nuk kanë

<sup>178</sup> Partice Canivez: "Éduquer le Citoyen", Paris, 2004, 32.

parashtruar kërkesë që Kuvendi të mbajë diskutim të përgjithshëm për propozimin.

**Leximi i dytë** fillon në trupin punues amë dhe në Komisionin juridiko-ligjvënës brenda afatit prej shtatë ditëve të punës pas seancës së mbajtur të Kuvendit për Leximin e parë ose pas skadimit të afatit për parashtrimin e kërkesës për diskutim të përgjithshëm për atë propozim. Në Leximin e dytë Propozimit i parashtrohen amendamente. Amendament mund të paraqesë çdo deputet, grup deputetësh dhe trupi punues. Amendamentet i paraqiten Kryetarit të Kuvendit, më së voni dy ditë para mbajtjes së mbledhjes të trupit punues amë ose Komisionit juridiko-ligjvënës. Trupi punues amë dhe Komisioni juridiko-ligjvënës për çdo amendament zhvillojnë diskutim dhe votojnë ndaras. Trupi punues amë dhe Komisioni juridiko-ligjvënës pas përfundimit të diskutimit në afat prej pesë ditësh hartojnë propozim-ligj të plotësuar në të cilin i inkorporojnë amendamentet e miratuara dhe të njëjtin ia dërgojnë Kryetarit të Kuvendit.

Në Leximin e dytë në seancën e Kuvendit shqyrtohen vetëm ato nene që kanë pësuar ndryshime përmes amendamenteve dhe vetëm për ato nene mund të paraqiten amendamente. Amendament mund të paraqesë grupi i deputetëve, çdo deputet dhe propozuesi, më së voni në afat prej tre ditësh para ditës së caktuar për mbajtjen e seancës së Kuvendit. Nëse në leximin e dytë të seancës së Kuvendit janë miratuar amendamente në më pak se një të tretën e neneve të propozim-ligjit të ndryshuar, Kuvendi mund të vendos që leximi i tretë i propozim-ligjit të mbahet në seancën e njëjtë. Nëse Kuvendi në leximin e dytë nuk miraton asnjë amendament ndaj propozim-ligjit të plotësuar atëherë kalohet në votim në po atë seancë. Nëse janë miratuar amendamente në më shumë se një të tretën e neneve të propozim-ligjit të plotësuar, pas leximit të përfunduar të dytë teksti i propozim-ligjit hartohet dhe përgatitet teknikisht e juridikisht për leximin e tretë.

**Leximi i tretë** sipas rregullës mbahet në seancën e parë të radhës, pas leximit të dytë. Amendamente mund të paraqiten vetëm për nenet për të cilët janë miratuar amendamente gjatë Leximit të dytë në seancë të Kuvendit, ndërkaq amendament mund të paraqesë propozuesi dhe deputeti më së voni në afat prej dy ditëve të punës para ditës së caktuar për mbajtjen e seancës së Kuvendit. Në këtë fazë trupat punues nuk mbajnë mbledhje. Kuvendi diskuton dhe vendos vetëm për ato nene për të cilët janë paraqitur amendamente ndaj propozim-ligjit të plotësuar për leximin e tretë dhe vendos për propozim-ligjin në tërësi. Me përjashtime të caktuara ligji mund të miratohet edhe me procedurë urgjente.

Me procedurë urgjente mund të miratohet ligji kur kjo është e domosdoshme për parandalimin dhe mënjanimin e çrregullimeve më të mëdha në ekonomi, ose kur këtë e kërkojnë interesat e sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës të Maqedonisë apo në raste të fatkeqesive më të mëdha natyrore, epidemive si dhe nevojave tjera të jashtëzakonshme dhe të pa prolonguar. Nëse Kuvendi vendos të diskutojë për propozimin, që ligji të miratohet me procedurë urgjente, e obligon trupin punues amë dhe Komisionin Juridiko-Ligjvënës ta shqyrtojë propozim-ligjin. Kur propozim-ligji shqyrtohet me procedurë urgjente, nuk mbahet diskutim i përgjithshëm. Leximi i dytë dhe i tretë mbahen në të njëjtën seancë. Në këtë rast fillon procedura e përcaktuar për leximin e dytë, ndërsa amendamente mund të paraqiten deri në përfundimin e diskutimit.

Ligji mund të miratohet edhe me procedurë të shkurtuar. Propozuesi i propozim-ligjit mund t'i propozojë Kuvendit, që të diskutojë për propozim-ligjin me procedurë të shkurtuar në rastin kur: nuk është në pyetje ligj kompleks dhe vëllimor, shfuqizohet ndonjë ligj ose dispozita të veçanta të ndonjë ligji ose nuk janë në pyetje harmonizime komplekse dhe vëllimore të ligjit me legjislacionin e Unionit Evropian. Kuvendi vendos nëse propozim-ligji do të miratohet me procedurë të shkurtuar. Kur propozim-ligji shqyrtohet me procedurë të shkurtuar nuk mbahet diskutim i përgjithshëm, me ç'rast menjëherë fillon procedura e përcaktuar për leximin e dytë,

ndërsa amendamente mund të paraqiten deri në fillimin e seancës për leximin e dytë.

Ligjet shpallen me dekret, të cilin e nënshkruan Presidenti i Republikës dhe Kryetari i Kuvendit. Kryetari i Kuvendit, menjëherë pas miratimit, ligjin ia dërgon Presidentit të Republikës, për nënshkrimin e dekretit për shpalljen e ligjit. Presidenti i Republikës mund të vendos që të mos e nënshkruajë dekretin për shpalljen e ligjit. Në këtë rast, Kuvendi e rishqyrton ligjin në fazën e leximit të tretë, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e miratimit të ligjit dhe nëse e miraton me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, atëherë Presidenti i Republikës është i detyruar ta nënshkruajë dekretin. Presidenti e ka për detyrë që ta nënshkruajë dekretin për shpalljen e ligjeve që janë miratuar me shumicën e dy të tretave. Para se të hyjnë ligjet në fuqi shpallen në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”. Ligjet shpallen më së voni brenda shtatë ditësh nga dita e miratimit të tyre<sup>179</sup>.

### Përfundim

Në çdo demokraci ekzistojnë një sërë institucione që mbajnë ekuilibër delikat dhe të nevojshëm për të mbajtur të qëndrueshëm funksionimin e sistemit politik.

Në demokracitë moderne në ditët e sotme këto institucione marrin formën e barazisë politike siç janë: zgjedhjet e lira dhe të ndershme, kontrollit dhe balancimit, autonominë e qytetarëve dhe burime të ndryshme të pavarura të informacionit së bashku me lirinë e shprehjes. Një qytetari e arsimuar dhe e pavarur është konsideruar gjithashtu vendimtare për mbajtjen e një demokracie me cilësi të lartë. Ndërsa shumë teori të demokracisë theksojnë rëndësinë

---

<sup>179</sup> <http://www.sobranie.mk/al/default-al.asp>

e niveleve të larta të participimit, ka të tjera që denoncojnë nivelet e larta të participimit si një kërcënim potencial për demokracinë.

Justifikimi për një sistem demokratik në teorinë e participimit rivendos demokracinë jo dhe aq shumë në efektivitetin e saj për qeverisje, por kryesisht në rezultatet e njeriut si individ, për mësim, eksperiencë e sidomos politike që janë të grumbulluara si rezultat i procesit të participimit. Modeli i participimit karakterizohet si një input ku maksimalisht pjesëmarrja është e nevojshme, prodhuar dhe përfshirë jo vetëm politika vendimmarrëse, por edhe zhvillimin e kapaciteteve sociale dhe politike të secilit individ. Kjo do të thotë që kapaciteti politik është edhe një rezultat dhe një parakusht për participim frytdhënës. Sistemi participues se vjen edhe bëhet më i qëndrueshëm, sepse pikërisht cilësitë që kërkohen nga qytetarët individual, nëse sistemi është që të punojë me sukses, atëherë janë pikërisht ato që procesi i participimit zhvillon dhe nxit. Dikush mund të pretendojnë se burim i flukseve politike formon qëndrimet dhe sjelljet e qytetarit të zakonshëm, dhe se institucioni i një procesi politik demokratik duhen të jenë të strukturuar për t'iu përgjigjur qytetarëve. Ky pohim ka nxitur debate në lidhje me aftësitë e publikut dhe cilësinë e participimit të qytetarëve që filloi me Aristotelin dhe Sokratin dhe vazhdojnë në faqet e revistave bashkëkohore të shkencave politike. Një nga rolet kryesore të qytetarëve në sistemin politik të demokracisë është për të marrë vendime në lidhje me çështjet politike. Në demokraci, kjo përfshin vendimi për të cilën, partitë ose kandidatët duhet mbështetur në zgjedhje, si dhe vendime për atë se cili dhe si duhet mbajtur pozita në politikë.

Sfida e vazhdueshme për demokracinë e qëndrueshme është tendenca për të zgjeruar më tej mundësitë për qytetarët që të marrin pjesë në procesin politik dhe më domethënëse është që struktura e vendimeve të ndikojnë në jetën e tyre. Për të përmbushur këtë sfidë, do të thotë se duhet siguruar një barazi e të drejtave politike dhe mundësive që është edhe më e vështirë për të garantuar me këtë formë të re të participimit. Megjithatë, një

përdorim i njëanshëm shoqëror i mundësive për të zgjeruar politikën nuk duhet të fajësojë mundësitë, por duhet të fajësojë politikën që dështonë për të zbutur paragjykimet shoqërore, të tilla si qasje të pabarabarta në arsim dhe përfitime të tjera sociale që ndikojnë tek resurset e qytetarëve për të participuar në politikë.

#### Referencat:

Lambro Filo: “Sistemet Politike Bashkëkohore”, Tiranë, 2010.

Montesquieu, ishte një komentator social francez dhe mendimtar politik i cili ka jetuar gjatë iluminizmit.

Patrice Canicez: “Éduquer Le Citoyen”, Paris, 1990, 30/31.

Russell J. Dalton; Hans-Dieter Klingeman: “The Oxford Handbook of Political Behaviour”, Wien, 2007.

Marija Risteska; Zhidas Daskalovski: “Krijimi i politikës zgjedhore në Republikën e Maqedonisë”, Shkup, 2008.

Iain Mcleandhe, Alistar McMillan: “Fjalori politik”, Oxford, 2011.

Ali Pajaziti: “Fjalor i sociologjisë, Logos-a, Shkup, 2009.

Jonuz Abdullahi: “Politika dhe politikën publike”, botimi i dytë, Tetovë, 2011.

Partice Canivez: “Éduquer le Citoyen”, Paris, 2004.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është botuar në „Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë“ numër 52/91, ndërsa amendamentet në „Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë“ numër 1/92, 31/98, 91/2001, 84/2003 dhe 107/2005.

[www.sobranie.mk](http://www.sobranie.mk)